



MARRËVESHJE

Për mënyrën e shfrytëzimit të shërbimeve të tregut valutor për klientët e Komercijalna Banka AD Skopje

Lidhur më _____, ndërmjet:

1. Komercijalna Banka AD Skopje, me seli në rr. Orce Nikollov, nr. 3 Shkup, me NUAE 4065573, e përfaqësuar nga Suzana Moskovska – Drejtore e Sektorit për likuiditet dhe tregun financiar (në tekstin e mëposhtëm: Banka), njëra palë dhe

2. _____, me seli në rr. _____ me NUAE _____, e përfaqësuar nga Menaxheri _____ (në tekstin e mëposhtëm: Urdhërdhënës), pala tjetër.

Neni 1

Me këtë Marrëveshje rregullohen kushtet themelore të punës ndërmjet Bankës dhe Urdhërdhënësit gjatë shfrytëzimit të shërbimeve të tregut valutor për klientët e Bankës me ndërmjetësimin e personave të autorizuar të Bankës.

Neni 2

Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, gjatë realizimit të transaksioneve individuale Urdhërdhënësi me Bankën lidhë marrëveshje të veçanta - Kontrata dhe të njëjtat janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Marrëveshjet individuale në emër të Bankës i lidh tregtari i Bankës, ose një person i autorizuar nga Drejtoria kompetente për tregtimin e instrumenteve financiare, ose nga njëra degë/filial i Bankës.

Në bazë të kësaj marrëveshjeje, Urdhërdhënësi mund të urdhërojë ekzekutimin e transaksionit - të shpejtë, ose sipas një termimi të paracaktuar - (me caktim fiks të: kursit, shumës dhe datës), gjatë orarit të punës së Bankës, përkatësisht nga ora 8:00 deri në orën 16:00, në njërin nga mënyrat, si në vijim: me telefon, me postë elektronike nëpërmjet email adresës: devizenpazar@kb.com.mk, nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë me ndonjë punonjës të autorizuar të Qendrës, ose të njëres nga degët e Bankës, ose nëpërmjet Bankës elektronike.

Në qoftë se Banka e ka konfirmuar se janë plotësuar kushtet për realizimin e urdhërpagesës, parashtruesi i kërkesës mund të negociojë marrëveshje individuale me Bankën, çdo ditë pune nga ora 8:00 deri në orën 15:45.



Neni 3

Urdhërdhënësi me ndërmjetësimin e Bankës, nëpërmjet Drejtorisë kompetente për tregtimin e instrumenteve financiare, mund të negociojë transaksionet e mëposhtme (të shpejta ose sipas terminit të paracaktuar):

1. Blerjen e mjeteve valutore të Urdhërdhënësit (nëpërmjet përpilimit të marrëveshjes së veçantë – konkluzionit – të shpejtë ose sipas terminit të paracaktuar), si pjesë përbërëse e transaksionit të caktuar;
2. Shitjen e fondeve në valutë të Urdhërdhënësit (nëpërmjet përpilimit të marrëveshjes së veçantë – konkluzionit – të shpejtë ose sipas terminit të paracaktuar), si pjesë përbërëse e transaksionit të caktuar;

Transaksioni i shpejtë (prompt) paraqet transaksion me afatin e ekzekutimit dhe të shlyerjes, jo më vonë se dy ditë pune nga data e lidhjes së kontratës.

Transaksioni sipas terminit të paracaktuar paraqet transaksionin me afat fiks të realizimit dhe barazimit të paracaktuar për të ardhmen, i cili nuk mund të caktohet në afat më të shkurtër se dy ditë pune nga data e marrëveshjes deri në datën e realizimit të transaksionit.

Neni 4

Nënshkruesit e Kontratës për shitblerjen e valutave për denarë janë theksuar më poshtë në vetë Kontratën, përkatësisht në rolin e nënshkruesit mund të paraqitet:

- a) dikush nga personat e shënuar në kartonin e nënshkruesve valutor në bankë;
- b) përfaqësuesi ligjor i shitësit/blerësit, ose;
- c) person i autorizuar nga ana e përfaqësuesit ligjor të shitësit/blerësit nëpërmjet autorizimit të veçantë.

Urdhërdhënësi obligohet të dorëzojë të dhëna për postën elektronike dhe numrin e telefaksit, ku Banka do t'i dërgojë kontratat.

Për çdo ndryshim të emrave të personave të autorizuar për përfaqësimin dhe negocimin e transaksioneve, si dhe për çdo ndryshim të të dhënave për postën elektronike dhe numrin e telefaksit, ku dërgohen kontratat, Urdhërdhënësi obligohet që menjëherë ta njoftojë Bankën. Banka nuk do të mbajë përgjegjësi për dëmin eventuale, që do të ishte si pasojë e plotësimit jo të rregullt të detyrimeve të Urdhërdhënësit të parapara në paragrafët paraprake të këtij neni dhe i njëjti do të bie mbi Urdhërdhënësin.

Neni 5

Marrëveshjet individuale të parapara në nenin 3, paragrafi 1, pika 1 dhe 2 e kësaj marrëveshjeje i obligojnë të dyja palët nëse janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 2, të kësaj Marrëveshjeje



Neni 6

Banka i dorëzon kontratat për të gjitha transaksionet e negociuara (të shpejta dhe sipas terminit të paracaktuar), të urdhërdhënësit nëpërmjet postës elektronike, personalisht ose me telefaks. Të gjitha kontratat që do të dorëzohen deri te Urdhërdhënësi, do të adresohen për personat e autorizuar të Urdhërdhënësit.

Urdhërdhënësi ka obligim që kontratat e nënshkruara nga personat e autorizuar t'i dorëzojë personalisht në Bankë, nëpërmjet postës elektronike në email adresën: devizenpazar@kb.com.mk, ose në numrat e faksit të publikuara në ueb faqen zyrtare të bankës.

Palët e kontraktuara, duke e nënshkruar këtë marrëveshje janë të njoftuar dhe pajtohen që të regjistrohen bisedat telefonike ndërmjet personave të autorizuar dhe tregtarëve të Bankës dhe personave të autorizuar nga Urdhërdhënësi, që kanë të bëjnë me realizimin e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje.

Palët e kontraktuara pajtohen se në rast të lindjes së kontestit eventual si pasojë e plotësimit ose mosplotësimit të detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje, parashtesave të dorëzuara nga cilado palë e kontraktuar, që bisedat telefonike të shërbejnë si dëshmi në procedurën e zgjidhjes së kontestit.

Neni 7

Të gjitha marrëveshjet individuale – kontratat, do të realizohen sipas afateve fikse të kontraktuara.

Neni 8

Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, në rast të plotësimit jo të rregullt të detyrimeve lidhur me datën e valutës në konkluzion deri në orën 15:45, të paraparë sipas cilësdo marrëveshjeje individuale – konkluzion (të shpejtë dhe sipas terminit të paracaktuar), Urdhërdhënësi pajtohet dhe e autorizon Bankën, në pajtim me dispozitat ligjore, pa patur nevojë për pajtim plotësues të tij ta realizojë mbulesën e pozicionit të saj valutator, ku humbjen do ta paguajë nëpërmjet:

- Lëshimit të instrumenteve të pagesës – urdhërpagesë për transferim në pajtim me Ligjin për qarkullimin e pagesave, me të cilët do t'i ngarkoj llogaritë e tij në denarë në Bankë dhe
- Vendosjes se urdhërpagesës dhe realizimin e pagesës nga të ardhurat valutore dhe mjetet valutore në llogaritë rrjedhëse të tij në valutë të huaj në Bankë.

Neni 9

Palët e kontraktuara pajtohen se kjo Marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët dhe lidhet për periudhë të pakufizuar.

Secila nga palët e kontraktuara ka të drejtë ta prish këtë Marrëveshje, duke e njoftuar me shkrim palën tjetër kontraktuese me afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.



Nëse urdhërdhënësi e prish këtë Marrëveshje me njoftim me shkrim deri te Banka, është i detyruar që gjatë afatit të prishjes së marrëveshjes prej 15 ditësh t'i plotësoj të gjitha detyrimet e mbetura ndaj Bankës dhe t'i kompensojë të gjitha dëmet e shkaktuara nga plotësimi i detyrimeve, në të kundërtën pajtohet dhe e autorizon Bankën pa pajtim plotësues të tij të njëjtat t'ia paguaj nga mjetet në llogaritë e Urdhërdhënësit.

Neni 10

Urdhërdhënësi, duke e nënshkruar këtë Marrëveshje vërteton se është i njoftuar dhe pajtohet me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që dalin nga kjo Marrëveshje, si dhe nga marrëveshjet individuale – kontratat të lidhura mbi këtë bazë.

Neni 11

Për gjithçka që nuk është paraparë me këtë Marrëveshje vlejné rregulloret nga dispozitat ligjore dhe aktet e Bankës.

Gjatë kontestit eventual sipas kësaj Marrëveshje, kompetent do të jetë Gjyqi në Shkup.

Neni 12

Kjo Marrëveshje është përpiluar në 2 (dy) kopje të ngjashme, nga të cilat secila palë e kontraktuar mban nga një (1).

KOMERCIJALNA BANKA AD SKOPJE

URDHËRDHËNËS
